

## SHKOLLA E MESME E PËRGJITHSHME

### PROFILI NATYROR

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen **disa orientime** lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në poezi dhe një në prozë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 22 kërkesa.

Në vlerësimin e esesë duhet pasur parasysh:

- Përgjigjja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të kërkesës, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni**, se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I

DRITËRO AGOLLI– Ora e gurit

Kërkesa 1	C	1 pikë
Kërkesa 2	C	1 pikë
Kërkesa 3	A	1 pikë
Kërkesa 4	B	1 pikë
Kërkesa 5	A	1 pikë

---

Kërkesa 6 4 pikë

**Model përgjigjeje**

Me anë të fjalës *gur* shënohet koncepti metaforik i kohës universale.

*Rrudhat prej dheu* shënojnë kohën njerëzore, përvojën historike (historinë e mundimshme dhe vuajtjet që ka kaluar ky popull).

**Interpretimi:** Koha universale është e përjetshme, ndërsa koha njerëzore është e përkohshme, e ndryshueshme. *Rrudhat prej dheu* në fushën e *gurit* (kohës universale) shënojnë përvojat e brezave, që e konkretizojnë këtë kohë dhe nuk e lënë më abstrakte.

Pa këtë përvojë njerëzore, koha do ishte diçka e palëvizur, një copë guri pa kuptim. Ajo bëhet konkrete dhe e lexueshme për ne, sepse vetë njerëzit e asaj kohe i dhanë kuptim.

**1 pikë** Nëse shpjegon metaforën e *gurit*.

**1 pikë** Nëse shpjegon metaforën e *rrudhave prej dheu*.

**2 pikë** Nëse shpjegon **qartësisht** ç' shënon secila prej tyre në poezi.

**1 pikë** Nëse shpjegon **pjesërisht** ç' shënon secila prej tyre në poezi. P.sh: Koha universale është e përjetshme, ndërsa koha njerëzore është e përkohshme, e ndryshueshme.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 7 4 pikë

**1 pikë** Poeti thjesht shënon një datë, atë të lindjes së Skënderbeut dhe vetëm përmend emrin e tij.

*Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I*

---

- 2 pikë** Ai nuk përdor asnjë fjalë himnizuese, të madhërishme, por mjaftohet me fjalët që shënon guri. Për Skënderbeun nuk ka nevojë për fjalë të tilla, mjaft të njohësh historinë për të vlerësuar madhësinë e figurës. Fjalët janë të varfra përpara përmasave të këtij njeriu. Në mënyrë formale, kjo tregohet dhe me përdorimin e vargut të shkurtër dhe të prerë: *Kur lindi këtu Skënderbeu.*  
Ose  
Dritëroi është realist dhe në dallim nga romantikët nuk himnizon, pasi nuk është misioni i realizmit ky i fundit.
- 1 pikë** Nga ana tjetër, poeti e shënon me fjalë datën e lindjes si për të dhënë përmasat e gjera dhe të thella të kësaj figure. Kjo formë imponon dhe shtrirje mendimi dhe krijimin e një imazhi sa të qartë aq edhe të thellë.  
Ose  
Kombinimi i një vargu të gjatë (vargu III) me vargun e shkurtër (vargu IV) krijon efekte të forta emocionale te lexuesi.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe nëse interpretimi që ka bërë, nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon atë të saktë.*

**Kërkesa 8     3 pikë**

**Model përgjigjeje**

**Interpretimi:** Ky varg shënon: rënie- ngritjet e historisë. Ky vend ka pasur çastet e tij të lavdishme dhe ato të errëta. Ka pasur momente shkëlqimi si dhe momente rënieje, gjumi dhe rizgjimi historik. Në historinë e tij gjenden natyrshëm të gjitha format e zhvillimit e të qytetërimit, por edhe ato kur ka pësuar kthim prapa. E gjithë kjo përvojë dialektike është shënuar natyrshëm në kujtesën e pagabueshme të gurit, që është dëshmitari i gjithçkaje ka ndodhur (luftërat, fitoret, humbjet).

Ose

Kuptimi i kohës si një proces ciklik, si kohë natyrore (gjurmët e kohës, jo nga pikëpamja e zhvillimit historik por nga pikëpamja e transformimeve natyrore, dëshmi e vjetërsisë së këtyre trojeve).

**2 pikë** Nëse interpreton saktë dhe qartë vargun.

*Matura Shtetërore 2007, Teste*

---

**1 pikë** Nëse e interpreton pjesërisht thelbin e këtij vargu. P.sh: Ky varg shënon rënie- ngritjet e historisë.

**1 pikë** Figura bazë është **antiteza**.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe nëse interpretimi që ka bërë, nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon atë të saktë.*

**Kërkesa 9 2 pikë**

**1 pikë** Shumësi i rregullt: *Ca mjegulla*

**1 pikë** Arsyeja është për përftesë metrike ose rime.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Kërkesa 10 1 pikë**

**1 pikë** Çift antonimesh: *vyshkje – blerim*

**Kërkesa 11 1 pikë**

**1 pikë** Sinonimi: *i ashpër* ose *i prerë*.

**0 pikë** Nëse nxënësi shkruan një sinonim që nuk ka lidhje me kontekstin e poezisë ose nuk përgjigjet fare.

**Kërkesa 12 10 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: IDEJA DHE ARGUMENTIMI**

**3 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- e ka kuptuar qartë në pikëpamje përmbajtjesore dhe artistike tekstin e dhënë (fragmentin)
- përcakton teknikat e përdorura nga autori për të arritur efekte të caktuara artistike
- interpreton në mënyrë analitike pjesën
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

*Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I*

---

**KRITERI II: STRUKTURA E ESESË**

**1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:  
hyrjen  
zhvillimin  
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

*Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.*

**KRITERI III: PASURIA GJUHËSORE**

**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shprehet me një gjuhë eseistike
- ka fjalor të pasur
- stil origjinal
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore dhe fjalëformimi

**KRITERI IV: LARMIA SINTAKSORE**

**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- zotëron sintaksën
- ka aftësi për të ndërtuar fjali që janë të sakta
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm
- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja sintaksore

**KRITERI V: SAKTËSIA DREJTSHKRIMORE**

**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- ka saktësi drejtshkrimore
- përdor si duhet shkronjën e madhe
- përdor si duhet shenjat e pikësimit

PJESA II

VIKTOR HYGO – Katedralja e Parisit

Kërkesa 13	C	1 pikë
Kërkesa 14	B	1 pikë
Kërkesa 15	B	1 pikë
Kërkesa 16	C	1 pikë
Kërkesa 17	B	1 pikë

---

Kërkesa 18                    2 pikë

- 1 pikë**    Rrëfimi është në vetën e tretë.  
**1 pikë**    Shkrimtari krijon distancë nga ngjarjet dhe personazhet, duke dashur të tregohet asnjans si rrëfimtar, pavarësisht simpativë të tij. Vepra fiton objektivitet.  
**0 pikë**    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Kërkesa 19    4 pikë

- 1 pikë**    Faza I: Esmeralda mbyll sytë kur sheh Kuazimodon dhe megjithatë portreti tij nuk i ndahet.  
**1 pikë**    Faza II. Pasi ai flet ajo e shikon, i afrohet, i flet, (*Ejani, ejani...*) e fton të vijë pranë saj.  
**1 pikë**    Faza III: Doli nga qelia, e zuri për krahu, kërkoj ta afroje, deshi ta fuste në qeli.  
**1 pikë**    Faza IV: Esmeralda ulet në shtrat dhe të dy bashkëbisedojnë; filloi të mësohej me të, thirri (i shkreti), nuk i bëri zemra të thoshte asnjë fjalë.  
**0 pikë**    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

### Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I

---

*Nëse nxënësi argumenton saktë se ky fragment ndahet në tri faza dhe rendit edhe foljet e duhura për secilën, atëherë ai do të marrë 4 pikët e plota.*

*Nuk është e detyrueshme që nxënësi t'i përmendë në përgjigje të gjitha foljet e dhëna në skemë. Për një përgjigje të saktë mjafton të përmendë edhe një pjesë të tyre, por që japin saktë thelbin për secilën fazë.*

*Nëse nxënësi thotë të katër fazat, por nuk gjen foljet tipike për secilën, atëherë do të vlerësohet me 0 pikë.*

#### **Kërkesa 20 1 pikë**

**1 pikë** Çift antonimesh: mbylli sytë- hapi sytë; bufi-lauresha, shëmti-bukuri.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

#### **Kërkesa 21 5 pikë**

**1 pikë** Dhimbja e Kuazimodos është shumë e madhe. Ai përqs pamjen e vet me atë të Esmeraldës dhe nga ky **kontrast** theksohet akoma dhe më shumë tragjizmi i kësaj figure.

**3 pikë** Përdorimi **i epiteve**: *i mjerë, e llahtarshme, i vrazhdë, i shëmtuar, i përçmuar*, shprehin intensitetin e dhimbjes dhe rrisin emocionalitetin e shprehjes.

Ndërkohë **inversioni**: *kurrë s'e kisha ndjerë kaq fort shëmtimin tim sa tani*, **epiteti metaforik**: *ai është përbindëshi i mjerë*, **krahasimi**: *si egërsirë*, **sendërzimi** (*dicka- send*), **enumeracioni**: *rrezja e diellit, cirk e vesës, kënga e bilbilit*, **polisindetit**: *as njeri dhe as kafshë* dhe **shkallëzimi zbritës** bashkë me **krahasimin**: *më i vrazhdë, më i shëmtuar, më i përçmuar se i një copë gur*, i shërbejnë pikërisht thellimit të këtij kontrasti dhe tregojnë ndjeshmërinë dhe botën e brendshme të këtij njeriu. Fataliteti që mbulon figurën e tij bëhet dhe më i dukshëm përballë bukurisë së Esmeraldës.

Nxënësi duhet të përmendë së paku **tri** nga figurat e mësipërme të stilistikës, bashkë me ilustrimet përkatëse dhe në funksion të zbërthimit të fragmentit.

*Nëse nxënësi gjen një figurë gabim atij do t'i zbritet një pikë.*

- 1 pikë** Shkaku i kësaj gjendjeje janë ndjenjat që ka trazuar Esmeralda në shpirtin e Kuazimodos, të cilat kanë bërë që ai të ndërgjegjësohet duke qenë më i vetëdijshëm për shëmtimin e vet. Ballafaqimi vetëm për vetëm me të, me një krijese kaq të bukur dhe me kaq mirësi, ka bërë që ai ta ndjejë shëmtimin e tij edhe më fort.
- 0 pikë** Nëse figurat përdoren gabim ose interpretimi bëhet pa iu referuar figurave apo thjesht përmenden disa figura të stilistikës po pa ilustrimet përkatëse.

**Kërkesa 22 3 pikë**

**1 pikë** Aforizma: *bufi nuk mund të hyjë në folenë e laureshës!*

**1 pikë Parimi I.**

Kjo thënie mund të interpretohet përmes parimit romantik të heronjve të jashtëzakonshëm të vendosur në situata të jashtëzakonshme. Të dy, edhe Kuazimodo edhe Esmeralda (*bufi dhe lauresha*) janë personazhe të jashtëzakonshëm dhe ndodhen në një situatë po aq të jashtëzakonshme. Kuazimodo është i jashtëzakonshëm për shkak të përçudnimit të jashtëm dhe bukurisë së brendshme. Esmeralda është e jashtëzakonshme për shkak të bukurisë absolute fizike dhe shpirtërore dhe fatit të saj të veçantë. Rrethanat në të cilat ata lidhen si, përballja me turmën dhe ngujimi në katedrale, janë të jashtëzakonshme.

Ose

I jashtëzakonshëm është edhe fakti që, mirësinë që zotërojnë, të dy personazhet e vënë në shërbim të të tjerëve.

**1 pikë Parimi dy**

Përdorimit të kontrasteve të mëdha për krijimin e efekteve tronditëse (*bufi dhe lauresha dhe simbolika që ata paraqesin*).

Ose

**Parimi tre**

Kjo është një fjalë e urtë e popullit dhe është një ilustrim i idesë se si romantikët dhe Hygoi, si një përfaqësues i tyre, janë mbështetur në kulturën dhe motivet popullore.

Ose



*Skemat e qortimit të testeve, letërsi sesioni I*

---

**Parimi IV**

Aforizmi është një shprehje e nënshtrimit të njeriut ndaj fatit të vet (tipar i romantizmit). Toni dëshpërues me të cilën ai pohohet na shfaq pikërisht një njeri të tillë.

Ose

**Parimi V**

Parimi i kultit të ndjenjës. Kemi të bëjmë me një ndjenjë, e cila i kapërcen kontrastet e jashtme.

**0 pikë** Nëse i referohet parimeve të tjera, jashtë kontekstit (historizmi, vendet ekzotike etj) ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi është i lirë t'i referohet dhe të bëjë interpretime për të paktën dy nga parimet e përmendura më sipër.*